



Npi – 01/268 Datë: 24.11.2020

Duke u bazuar në nenin 12.2, pika (d) nenet 81 dhe 82 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Qershor 2008); Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën e Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Nr. 020-777/2 datë: 27.10.2020, për Rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01-209, për shpalljen me interes të përgjithshëm N.K-Nr.230-0 dhe Nr.251-0 Z.K-Dugë. Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2020, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES **Npi – 01/209 TË DATËS: 29.09.2020**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më 24.11.2020, me shumicën e votave vendosi të ANULOJË Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/209, të datës 29.09.2020, për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të pa luajtshme të Komunës së Shtimes, N.K : Nr.230-0; Me sipërfaqe 35231m²; Si dhe N.K : Nr.251-0; Me sipërfaqe 3859m²; Z. K. – Dugë; Evidentuar, Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim 30 vite.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj